VENDIM
Nr. 44, datë 19.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 2.6.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Frensis Qazolli

SUBJEKTE TË INTERESUAR: Shoqëria e Sigurimeve “Atlantik” sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 6 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi në datën 19.6.2010, gjatë drejtimit të mjetit tip “Audi” me targë TR8609P, është përfshirë në një aksident automobilistik në Tiranë. Sipas procesverbalit të Policisë Rrugore rezulton se shkaku i aksidentit ka qenë mosrespektimi i nenit 139/2 të Kodit Rrugor, sepse ka humbur kontrollin e mjetit dhe ka goditur bordurën e urës, duke e dëmtuar rëndë atë dhe duke përfunduar në kanal.

2. Mjeti tip “Audi” me targë TR8609P ka qenë i siguruar me kontratë sigurimi kasko nr. 010865, datë 19.5.2010. Për këtë arsye kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve “Atlantik” sh.a., me kërkesë për dëm-shpërblim. Kjo e fundit ka refuzuar dëmshpër-blimin, pasi, sipas saj, shkaku i aksidentit i përcaktuar nga Policia Rrugore lidhej me nenin 139 të Kodit Rrugor, që parashikon *shpejtësinë* gjatë drejtimit të mjetit dhe aksidentet e ndodhura për këtë shkak nuk mbulohen nga shoqëria e sigurimit sipas rubrikës “Përjashtime” të kontratës së sigurimit.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt shpërblimin e plotë të dëmit sipas kontratës së sigurimit kasko nr. 010865 për mjetin tip “Audi” me targë TR8609P të dëmtuar si pasojë e aksidentit automobilistik të datës 19.6.2010, si dhe kamatat e arrira të shumës së paakorduar në kohë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7047, datë 19.9.2011, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurit “Atlantik” sh.a. që t’i paguajë paditësit Frensis Qazolli shumën prej 19.200 eurosh si detyrim kontraktor të papaguar që rrjedh nga polica e sigurimit kasko nr. 010865, datë 19.5.2010.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1963, datë 19.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kundër vendimit nr. 1963, datë 19.7.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs subjekti i interesuar, shoqëria "Atlantik" sh.a.. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1963, datë 19.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Frensis Qazolli.

II

6. Kërkuesi Frensis Qazolli i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1 Është cenuar *parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke bërë interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara dhe vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, ka vepruar tej kompetencave të tij. Arsyetimi i vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bie ndesh me provat e administruara dhe të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

6.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me ligjin material, pasi interpretimi që ajo ka bërë lidhur me nenin 139/2 të Kodit Rrugor, kontratën e sigurimit kasko dhe nenet 1113 e vijues të Kodit Civil (KC) është i gabuar. Gjykata e ka shqyrtuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes duke iu referuar nenit 139 të Kodit Rrugor.

6.3 Gjykata e Lartë me vendimin e saj ka vlerësuar e zbatuar gabim nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sepse rekursi nuk përmban asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për shqyrtimin gjyqësor të tij.

6.4 Gjykata e Lartë nuk ka respektuar nenet 12, 29 dhe 309 të KPC-së. Kjo ka sjellë humbjen e besimit në objektivitetin dhe paanshmërinë e dhënies së vendimit të drejtë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organi-zimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

8. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij hyjnë në juridiksio-nin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e çështjes

B.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

9. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ato dhe duke tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*". Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të

vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Procesi konsiderohet i rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese rezulton se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, nga aktet bashkë-lidhur kërkesës, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur se "*Gjykata çmon se në kontratën e sigurimit kasko është parashikuar si rast përjashtimor që i humbet të drejtën të siguruarit, tejkalimi nga ana e këtij të fundit (përdoruesit të mjetit) të normave të shpejtësisë. Nga ana tjetër, dispozita e cituar nga policia rrugore si shkak i aksidentit është neni 139/2 i Kodit Rrugor, i cili ndonëse përfshihet te një nen që titullohet "Shpejtësia", gjithsesi parashikon se "2. Drejtuesi i mjetit duhet të ruajë gjithmonë kontrollin e mjetit dhe të jetë në gjendje të kryejë të gjitha manovrat e nevojshme në kushte të sigurta, veçanërisht frenimin e menjëhershëm të mjetit brenda kufijve të fushëpamjes dhe përpara çdo pengese të mundshme.*".

Nga procesverbali i policisë rrugore nuk rezulton të jetë përcaktuar shpejtësia me të cilën ka qenë mjeti në momentin e humbjes së kontrollit nga drejtuesi i saj. Kësisoj, nuk mund të konkludohet nëse shkaku i ndodhjes së aksidentit ka qenë tejkalimi i normave të shpejtësisë nga drejtuesi i mjetit tip "Audi", por duhet pranuar versioni i thënë në proces-verbalin e konstatimit të shkeljes (akt zyrtar me fuqi të plotë provuese) se aksidenti ka ndodhur si rrjedhojë e humbjes së kontrollit mbi mjetin nga drejtuesi i tij, pa u lidhur ky fakt me tejkalimin e shpejtësisë. Humbja e drejtimit të mjetit mund të ndodhë për shumë shkaqe dhe tejkalimi i shpejtësisë mund të jetë vetëm njëri prej tyre. Për sa kohë që nuk përcaktohet dot ky parashikim kontraktor, atëherë mbi palën e paditur rëndon detyrimi i pagimit të shumës sipas policës së sigurimit kasko.".

14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1963, datë 19.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me arsyetimin: "*Në kushtet kur pala e paditur në gjykim nuk ka arritur të provojë rastin përjashtimor të mbulimit të kontratës së sigurimit dhe për sa kohë nuk përcaktohet dot ky parashikim kontraktor, por vetëm mbetet në kuadrin e prapësimeve, atëherë drejt Gjykata e Rrethit ka arritur në përfundimin se mbi palën e paditur rëndon detyrimi i pagimit të shumës sipas policës së sigurimit kasko. Në këto rrethana, ndryshe sa pretendohet në ankim se gjykata ka zbatuar gabim ligjin material, me provat e paraqitura në gjykim ka rezultuar se padia e paditësit Frensis Qazolli të jetë e mbështetur në ligj, nenet 419, 420 etj. 1137 të Kodit Civil, prandaj vendimi i Gjykatës së Rrethit nuk ka vend që të bëhet i cenueshëm.".*

15. Ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*duke qenë se paditësi Frensis Qazolli ka kryer një kundërvajtje administrative (shkelje me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim), e cila është parashikuar shprehimisht në nenin 139§2 të Kodit Rrugor, i cili titullohet "Shpejtësia" dhe për këtë shkelje paditësi është ndëshkuar me gjobë në masën dy mijë lekë (neni 139§10 i Kodit Rrugor), atëherë ngjarja e ndodhur nuk përfshihet në rastet e sigurimit të parashikuara nga ana e palëve ndërgjyqëse në Kontratën e Sigurimit Kasko, pasi në këtë kontratë, në rubrikën "Përjashtime" të Kushteve të Përgjithshme, është përcaktuar shprehimisht se siguruesi nuk mbulon "dëmet si rezultat i tejkalimit të normave të shpejtësisë ... dhe/ose për shkak dhe neglizhencë të rëndë të të*

siguruarit.".

16. Gjykata Kushtetuese është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Edhe në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil ka rivlerësuar provat e administruara e të vlerësuara nga gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil ka arsyetuar se shkak i aksidentit ka qenë tejkalimi i shpejtësisë, pavarësisht se kjo nuk provohet në vendimet e gjykatave më të ulëta të bazuara në një akt zyrtar, procesverbalin e mbajtur nga Policia Rrugore. Gjykata e Lartë edhe pse nuk ka vënë në dyshim vlerën e këtij akti zyrtar, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të faktit dhe për rrjedhojë të provave, duke ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta.

18. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor si pasojë e shpejtësisë së madhe, duhet të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit duke dhënë udhëzimet përkatëse në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtruar provat hetimit të plotë gjyqësor. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj[1].

B.2 Në lidhje me pretendimet e tjera

19. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me ligjin material, pasi interpretimi që ka bërë ajo gjykatë lidhur me nenin 139/2 të Kodit Rrugor dhe nenet 1113 e vijues të Kodit Civil është i gabuar. Gjithashtu, sipas kërkuesit, Kolegji Civil ka kryer shkelje procedurale, sepse ka zbatuar gabim nenet 12, 29, 309 dhe 472 të KPC-së, çka ka sjellë humbjen e besimit në objektivitetin e dhënies së një vendimi të drejtë.

20. Referuar natyrës ligjore të këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se çështjet e pretenduara nga kërkuesi i takojnë juridiksionit të zakonshëm dhe jo kategorisë së çështjeve që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

[1] Gjyqtarët V. Kristo dhe G. Dizdari votuan për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka atribuuar vetes kompetenca të pa autorizuara nga ligjvënësi sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 35, datë 27.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushte-tutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo

Anëtarë kundër: Besnik Imeraj, Fatos Lulo